



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 78/2012
Prishtinë, më 02.10.2012, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, zëvendëskryetare, Sala Berisha-Shala, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Zenun Pajaziti, Fikrim Damka, Berat Buzhala, Hashim Deshishku dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Dita Dobranja- INDEP dhe Flamur Hyseni - NDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, **Teuta Sahatqija - zëvendëskryetare e Komisionit.**

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.09.2012;
3. Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për efciencen e energjisë;
4. Njoftimi i Komisionit me shkresën e KPU Inspekt;
5. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.09.2012

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur, më 25.09.2012, u miratua pa vërejtje.

3. Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë

Kryesuesja – Tha se mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë është i paraparë edhe në Planin e Punës së Komisionit për vitin 2012. Komisioni në bashkëpunim me organizatën INDEP, e ka organizuar një tryezë, ku e ka shqyrtuar analizën e hartuar nga ana tyre për eficiencën e energjisë në Kosovë.

Po ashtu, Komisioni unanimisht nxori këtë

V E N D I M

1. *Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit Nr. 04/L-016 për eficiencën e energjisë;*
2. *Grupi punues ka këtë përbërje: Visar Ymeri, raportues, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku dhe Myzejene Selmani, anëtarë;*
3. *Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit punues gjatë punës së tij;*
4. *Grupi punues, në bashkëpunim me njësinë koordinuese të Komisionit të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

4. Njoftimi i Komisionit me shkresën e KPU Inspekt

Kryesuesja – Tha se këtë njoftim të KPU Inspekt e ka dërguar Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, ku e kanë shpallur Komisionin e tyre si jokompetent, me arsyetimin se për këtë çështje është Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Propozoj që kjo pikë e rendit të shtyhet për mbledhjen e radhës, pasi që të analizohet më në detaje nga ana e anëtarëve të Komisionit.

Propozimin e kryesueses e përkrahën anëtarët e Komisionit.

5. Të ndryshme

Çështje vijuese;

Kryesuesja – I njoftoi anëtarët e Komisionit se është proceduar për lexim të dytë projektligji për komunikime elektronike dhe, do të procedohet sot edhe projektligji për mbrojtjen e konsumatorit pasi që i ka plotësuar kushtet sipas Rregullores së Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Teuta Sahatqija

Zëvendëskryetare e Komisionit